# TRIBUNA SINDIKALE

Shkurt 2008

*Dhe drit' e diturisë*
*përpara do na shpjerë*






Editorial

# ME SHUME SHERBIME PER MESUESIT SINDIKALISTE

Ne stafet drejtuese qendrore te te dy sindikatave te arsimit, por edhe me gjere, prej disa kohesh po diskutohet rreth temes se cfare sherbimesh duhet t'u ofrojne sindikatat anetareve te tyre.

Disa vite me pare, Sindikatat e Arsimit, si FSASH ashtu edhe SPASH, ishin dhe per shume kohe mbeten te angazhuara ne probleme ekonomike dhe sociale qe lidheshin me mbrojtjen e interesave dhe kerkesave te te gjithe mesuesve. Dhe nuk kishte se si te mos ndodhte keshtu. Nevoja jetike per rritjen e pagave, per permiresimin e sistemit te shperblimeve ne teresi, garantimi i kohes dhe kushteve te punes, kualifikimi i mesuesve, e mbi te gjitha perpunimi dhe perfshirja ne Kontraten Kolektive te Punes te standardeve qe lidhen me punesimin, levizjet nga vendi i punes dhe largimin nga puna, shoqerimi dhe mbrojtja e ketyre kerkesave me levizje te ndjeshme dhe disa here te fuqishme sindikale, perbenin fushen kryesore te veprimtarise se sindikatave te arsimit gjate tranzicionit. Nga parashtrimi dhe zgjidhja e ketyre kerkesave jetike nuk kane perfituar vetem mesuesit sindikaliste, por e gjithe masa e mesuesve, ashtu sic eshte e vertete se ne levizjet sindikale qe jane organizuar per mbrojtjen dhe zgjidhjen e ketyre kerkesave nuk kane marre pjese vetem sindikalistet, por e gjithe masa e mesuesve.

Vitet e fundit, edhe ne Shqiperi, levizja sindikale ne arsim eshte futur ne nje etape te re. Kontratat Kolektive te Punes, qe perbejne bazen ligjore te marredhenieve midis punedhenesit dhe sindikatave ne te gjitha nivelet jane permiresuar. Ato perfshijne aspektet kryesore ekonomike dhe sociale te mbrojtjes se mesuesve, perfshire pagat, shperblimet, kohen e punes, kushtet e punes dhe te punesimit, lirite sindikale etj. Nga keto marredhenie te institucionalizuara midis Qeverise, Ministrise se Arsimit e Shkences, nga njera ane, dhe FSASH e SPASH nga ana tjeter, natyrshem perfitojne sindikalistet, por perfitojne edhe te gjithe mesuesit e punonjesit qe nuk jane te anetaresuar ne asnjeren sindikate. Duke qene se, keto vitet e fundit, ne pergjithesi, shumica e ketyre kerkesave jane zgjidhur e po zgjidhen nepermjet dialogut social, bisedimeve te vazhdueshme, forces argumentuese dhe bazueshmerise ligjore, nuk ka lindur nevoja qe ato te shoqerohen me levizje sindikale, me greva apo protesta. Kjo gjendje, e shoqeruar edhe me mungesen e traditës e te kultures sindikale, nga njera ane, ka krijuar nje ftohje te mesuesve josindikaliste ndaj sindikatave, nje qendrim indiferent ndaj tyre, dhe nga ana tjeter, me te drejte, ka rritur kerkesat e mesuesve te anetaresuar ne sindikate ndaj organeve qendrore te tyre per sherbime te vecanta ne fushen ekonomike e sociale qe duhet t'u ofrohen atyre, ose thene me troc duhet t'i perfitojne vetem sindikalistet.

Keto kerkesa te anetareve tane nuk kane lindur sot. Por edhe puna per plotesimin e tyre nuk fillon tani. Pothuaj ne te gjitha Kontratat Kolektive te nivelit te pare qe jane nenshkruar deri me sot, eshte bere kujdes qe ne to te perfshihen disa sherbime qe i perfitojne vetem sindikalistet. Konkrete eshte shperblimi qe perfitojne vetem mesuesit sindikaliste qe dalin ne pension, te cileve sindikatat e arsimit u garantojne dhenien e deri dy pagave mujore neto. Po keshtu, kur eshte fjala per konflikte qe mesuesit kane me punedhenesin, me Drejtorite Rajonale apo Zyrat Arsimore, qofshin keto per masa disiplinore, transferime, largime nga puna, kohen e pushimit vjetor etj, sindikatat e arsimit perfaqesojne dhe marrin ne mbrojtje vetem mesuesit sindikaliste.

Por, tani po forcohet opinioni se Sindikatat e Arsimit duhet te ofrojne me shume sherbime vetem per anetaret e tyre, sepse keto qe jane bere deri tani nuk jane te mjaftueshme. Per kete po diskutohet ne kryesite dhe keshillat drejtuese te sindikatave qendrore, po diskutohet ne seksionet dhe keshillat sindikale te bazes. Mendimet, sugjerimet dhe propozimet qe jane bere do te behen objekt diskutimi ne nje tryeze qe do te organizohet ne Qendren e Sindikatave te Arsimit ne Tirane me 23 shkurt 2008. Per te garantuar suksesin e kesaj tryeze ne kemi terhequr mendime edhe nga sindikatat e arsimit te Hollandes, Italise, Sllovenise, Frances, Maqedonise, etj. Kolege nga Sindikata Holandeze e Arsimit, AOb, do te jene pjesemarres te kesaj Tryeze dhe do te ndihmojne me pervojen e tyre.

Konkluzionet e Tryezes se 23 shkurtit per sherbimet qe sindikatat e arsimit duhet t'u ofrojne anetareve te tyre do te perbejne bazen per negocime te reja midis SPASH e FSASH dhe Ministrise se Arsimit e Shkences per plotesimin dhe shtesat perkatese qe do te behen ne Kontraten ekzistuese Kolektive te Punes.

Xhafer Dobrushi

# PERMBAJTJA


- *Editorial:* Me shume sherbime per mesuesit sindikaliste 2
- Angazhim rezulutativ i mesuesve e nxenesve te Korces 3
- Baza e arritjeve, puna individuale me nxenesit 5
- Takime te rendesishme me perfaqesues te DAR e ZA ne qarqet e Korces dhe Fierit 7
- Me shume angazhim e pergjegjesi nga ana e drejtuesve te seksioneve ne rrethe *(Nga mbledhja e KD te FSASH)* 7
- Te zbatojme Kontraten Kolektive te Punes dhe te sigurojme me shume sherbime per anetaret *(Nga mbledhja e KK te SPASH)* 9
- Mbi reformen e sistemit te zhvillimit profesional te mesuesve 10
- T'i mësojmë nxënësit si të punojnë me librin *Nga Bashkim Saliasi* 12
- Kishim vepruar drejtë *Nga Viron Kona* 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15


**Kopertina e pare:**
*Nxenes te shkolles "Asdreni", Korçe, ne nje koncert ne kuadrin e veprimtarive te seminarit per parandalimin e punes se femijeve*

**Kopertina e fundit:**
*Nga seanca me pjesemarrjen e partnereve te angazhuar per eliminimin e punes se femijeve ne rrethin e Fierit*


**TRIBUNA SINDIKALE**
**Nr. 32, Periodike**
*Botim i FSASH dhe SPASH*
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV



*ADRESA :*
*Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik, Kati i 3-te, Tirane*
*Tel & Fax + 355 4 25 65 32*
*Celular: + 355 68 20 34 674, + 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891*
*E-mail: fsash@abcom-al.com*
*Internet: www.fsash-spash.com*



**Keshilli Botues:**
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

Nga aktivitetet e Projektit FNV/AOb

# Angazhim rezulutativ i mesuesve e nxenesve te Korces

## Nga seminari per eliminimin e punes se femijeve

Seminari mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve ne rrethin e Korces, organizuar per tri dite me radhe ne ambientet e Hotel Grand ne Korce, shenoi nje moment te rendesishem te punes qe po behet ne kete rreth ne zbatim te projektit me sindikatat holandeze FNV/AOb. Ai ishte nje gershetim i 22 pjesemarres, kryesisht nga shkollat pilot, por edhe anetare te Grupit te Punes ne nivel rrethi, si edhe nga disa shkolla te tjera, moren pjese ne seminar. Te dy kryetaret e sindikatave qendrore te arsimit, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, si edhe ekspertet holandeze Martin Kircz dhe Michel Kersten moren pjese, duke qene shume aktive gjate diskutimeve alit mbi Arsimin Jo-Formal.

Sesioni i mengjesit, ne diten e dyte te seminarit, u organizua ne ambientet e shkolles "Asdreni", ku pervec seminaristeve, moren pjese edhe drejtues te kesaj shkolle, mesues, perfaqesues te nxenesve e prinderve.

Ne prezantimin e vete kryetarja e sindikates se shkolles, Marta Xharo, evidentoi punen e bere gjate periudhes qe nga fillimi i angazhimit ne kuadrin e projektit me sindikatat holandeze, ku jane angazhuar, pervec grupit te punes te ngritur ne shkolle, edhe disa mesues te tjere, te cilet kane plotesuar pytesoret dhe kane marre ne kujdestari per te ndihmuar nga afer 22 nxenes, vecanerisht nga komuniteti Rome, me te cilet eshte bere nje pune e diferencuar dhe eshte arritur qe 5 prej tyre te integrohen



spjegimeve teorike mbi standardet nderkombetare dhe legjislacionin shqiptar per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre, me analizen e punes konkrete qe po behet ne kete rreth e vecanerisht ne kater shkollat pilot, ("Asdreni", "Naim Frasheri", Sheqeras e Pojan), ku qe prej me shume se 8-9 muajesh po punohet konkretisht per shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve.

qe u bene ne seminar.

Perfaqesuesja e ILO-IPEC prane Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barbarta, Shkelqesa Manaj, organizoi dy sesione interaktive gjate dites se pare te seminarit, duke u marre kryesisht me standardet nderkombetare dhe legjislacionin shqiptar mbi mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se tyre, si edhe me spjegimin e paketes se Moduleve SCREAM dhe Manu-

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

teresisht ne klasat perkatese, nderkohe qe kjo pune do te vazhdoje edhe me disa nxenes te tjere qe vijojne me hope ose nuk pervetesojne si duhet porogramin mesimor. Prezent ne kete seance, nxenesi Ergys Bleta shpjegoi vete se si, me ndihmen e mesueseve Zhani e Juli dhe te disa shokeve e shoqeve te klases, e kuptoi gabimin qe kishte bere duke braktisur shkollen dhe u kthye ne rrugen e mbare te vazhdimit rregullisht te saj. Mesues e



nxenes te kesaj shkolle, krahas dikutimeve dhe paraqitjes se pervojes se tyre ne punen me nxenesit ne rrezik per te braktisur shkollen, kishin pergatitur edhe nje program te bukur artistik, te integruar natyrshem me tematiken e seminarit, duke emocionuar se tepermi te gjithe pjesemarresit ne kete aktivitet te bukur e domethenes. Angazhimi i drejtperdrejte i drejtorit te shkolles, Ylli Kreka dhe zv/drejtoreshes Zhani Mlloja, per organizimin e ketij aktiviteti ishte nje shembull i mire per te gjithe pjesemarresit, perfshire edhe perfaqesuesit e sindikates holandeze, AOb, te cilet u shprehen me fjalet me te mira per punen e bere ne kete shkolle.

Seanca e mbasdites u organizua ne formen e nje Tryeze me pjesemarrjen edhe te drejtorit te Drejtorise Arsimore Rajonale Andrea Mano, si edhe te perfaqesuesve nga Keshilli i Qarkut, nga Komisariati i Policise, si edhe nga organizata Joqeveritare, Ndihme per Femijet dhe shoqatat e Romeve. Ne kete seance, ne emer te dy seksioneve sindikale te SPASH e FSASH, foli kryetarja e SPASH per Korcen, Albina Pepo, e cila vuri ne dukje se ne kuadrin e ketij Projekti eshte duke u bere nje pune e organizuar sidomos ne kater shkollat e perzgjedhura, ku jane subjekt i punes individuale qe mesuesit jane duke bere rreth 104 nxenes, ndersa ne shkalle rrethi ky numer shkon rreth 200 nxenes.

Si rezultat i kesaj pune, 38 nxenes kane dale nga rreziku i braktisjes se shkolles dhe po e vijojne normalisht ate, nderkohe qe kjo pune vazhdon edhe me nxensit e tjere te perzgjedhur per te punar individualisht ne kuadrin e ketij Projekti. Ne vijim, ajo vuri ne dukje disa nga format me efikase te punes, duke e vene theksin tek bashkepunimi me nxenes e prinder, por edhe me aktoret e tjere ne shkolle e jashte saj, ne komunitet.

Drejtori i Drejtorise Arsimor Rajonale, perfaqesuesja e Qarkut, perfaqesuesja e Shoqates Ndihme per Femijet, vleresuan punen e bere nga ana e sindikatave e mesuesve dhe shprehen angazhimin e tyre per ta mbeshteur kete iniciative, duke dhene secili subjekt kontributin e vete ne sektorin perkates.

Seancat e se shtunes ishin diskutime konkrete mbi gjendjen ne secilen prej shkollave dhe punen e secilit prej pjesemarresve ne seminar, eksperiencen e fituar, problemet me te cilat ata jane ndeshur gjate kesaj periudhe 8-9 mujore qe nga fillimi i zbatimit te ketij Projekti, duke u fokusuar sidomos tek puna me femijet e komunitetit Rome, shumica e te cileve jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, edhe per shkak te mentalitetit te prinderve, vecanerisht kur eshte fjala per te vazhduar klasat e larta te shkolles 9-vjecare dhe, aq me teper, shkollen e mesme.

Kolegu nga Holanda, Marten Kircz, prezantoi, ne vijim, pervojen holandeze ne lidhje me punen e sindikates se arsimit per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, duke e vene theksin sidomos tek sistemi i monitorimit dhe puna individuale me secilin prej nxenesve ne rrezik per te braktisur shkollen ose ata qe jane te angazhuar ne pune.

Ne fund te seminarit, pas nderhyrjeve dhe konkluzioneve te drejtuesve te FSASH e SPASH, u paraqiten propozimet per programin e veprimit, i cili do te perpunohet me tej dhe do te paraqitet per miratim e veprim ne mbledhjen e ardheshme te Grupit te Punes qe vepron ne nivel rrethi.

Duhet theksuar se ky seminar u organizua pas nje pune te gjithaneshme qe eshte bere nga ana e me shume se 55 mesuesve, me mbi 200 nxenes, te cilet kane qene dhe vazhdojne te jene subjekt i nje pune individuale, 103 prej te cileve ne shkollat e perzgjedhura, te cilet jane integruar ose pritet te integrohen se shpejti ne jeten normale te klasave e shkollave perkatese.

Stavri Liko

# Baza e arritjeve, puna individuale me nxenesit

## Nga seminari per eliminimin e punes se femijeve ne Fier

Ne seminarin e organizuar ne Fier moren pjese 29 pjesemarres, kryesisht nga kater shkollat pilot, (Levan, Reoskovec, Zhupan e Mbrostar), por edhe anetare te Grupit te Punes qe vepron ne nivel rrethi, perfaqesues te disa shkollave te tjera, te Drejtorise Arsimore Rajonale, te Prefektures dhe Shoqates Rome "Amaro Drom".



Moren pjese, gjithashtu, dy drejtuesit e sindikatave tona te arsimit, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja.

Seminari u zhvillua sipas formatit te zakonshem, duke gershetuar pjesen teorike ne lidhje me standardet nderkombetare dhe legjislacionin shqiptar per mbrojtjen e femijeve me analizen e punes se bere dhe te detyrave qe dalin ne vijim per eliminimin e punes se tyre.

Seanca me rendesishme e seminarit ishte ajo e te premtes ne mengjes, ku ne prezence edhe te Drejtorit te Drejtorise Arsimore Rajonale, Z. Tahir Kastrati dhe te perfaqesuesve te Prefektures, Bashkise, Zyres se Punesimit, drejtuesve te Keshillave Sindikale te te dy konfederatave, BSPSH e KSSH, shoqates se Romeve etj, u be nje analize e hollesishme e punes se bere ne keto shkolla dhe u diskutua gjeresisht ne lidhje me zgjerimin e pjesemarrjes se mesuesve ne punen individuale me nxenesit, si edhe forcimin e bashkepunimit me te gjithe aktoret qe veprojne ne shkolle e jashte saj, ne komunitet, per arritjen e rezultateve konkrete ne kete ceshtje jetike per zhvillimin progresiv te shoqerise.

Ne fillim, drejtuesit e grupeve te seciles prej 4 shkollave pilot informuan pjesemarresit mbi punen e bere dhe rezultatet e arritura deri tani, duke u ndalur posacerisht edhe tek zgjerimi i angazhimit te mesuesve per shmangien e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve.

Duke folur per punen e bere dhe situaten aktuale ne shkollen e Levanit, mesuesi Arqile Bitri, njeri nga aktivistet me te mire te kesaj zone ne punen individuale me nxenesit, theksoi se mbi 15 mesues jane te angazhuar ne kete shkolle duke punuar me perkushtim, jo vetem ne klase e ne shkolle, por edhe jasht tyre, ne familjet e nxenesve e ne komunitet, duke arritur rezultate shume te mira, pavaresisht nga veshtiresite qe ndeshen, sidomos me nxenesit nga komuniteti Rome. Me tej ai foli per dy raste specifike, si ai i Valbona e Gazmir Brucaj, moter e vella, dhe Makeliana Selimi, te cilet e kishin braktisur shkollen disa kohe me pare, por jane duke e vazhduar ate rregullisht tani, pas nje pune kembengulese bindese me vete ata, por edhe me prinderit e te afermit e tyre.

12 mesues jane te angazhuar ne nje pune te tille edhe ne shkollen e Roskovecit, te cilet e filluan aktivitetin me njohjen e karakteristikave te vecanta te cdo nxeesi qe kishte braktisur ose ishte ne rrezik per ta braktisur shkollen dhe, pas kesaj, ndertuan punen individuale me secilin prej tyre, sipas specifikave te evidentuara. Midis 30 nxenesve, subjekt i punes se ketyre mesuesve, 7 prej tyre e vazhdojne normalisht shkollen, ndersa me 13 te tjeret puna eshte ne vazhdim, me synimin qe edhe ata te integrohen plotesisht ne klasat perkatese dhe te arrijne rezultate te mira ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Duke folur per kete pervoje, kryetarja e grupit te punes ne kete shkolle, Fatmira Toska, dhe mesuesja Arjana Plaka permenden me emra nxenesit Endra Kasa, Ani Kola, Adriana Metani, Renato Spahiu etj, te cilet po vijojne rregullisht ne shkolle, duke patur edhe rezultate te mira, pas nje pune kembengulese qe eshte bere dhe eshte duke u bere me secilin prej

Vijon në faqen 6

Vijon nga faqja 5

tyre ne menyre individuale. Kryetarja e Senatit te Nxenesve ne kete shkolle, Benilda Baba, pjesemarrese ne seminar, foli gjeresisht ne lidhje me rolin e vete nxenesve qe punojne se bashku me Grupin e Punes, me shoket e shoqet e klases qe kane braktisur ose jane ne rrezik per ta braktisur shkollen. Ajo tregoi konkretisht per rastin e nxeneses Adriana Metani, e cila u perfshi ne grupin e nxenesve te dalluar qe moren dhurata, duke e inkurajuar ate drejtperdrejt per kthesen e bere ne shmangien e mungesave ne oret e mesimit dhe pervetesimin e lendeve mesimore. Po keshtu, ajo permendi rastin e nxenesit Jashar Çepele, te cilit iu dha roli kryesor ne komedine "Kater-mbedhjete vjec dhender", e cila u vu ne skene nga grupi teatral i kesaj shkolle, gje qe ka patur nje ndikim te drejtperdrejte pozitiv ne pjesemarrjen ne mesim dhe rezultatet e tij ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Metoda te tilla inkurajuese per disa nga keta nxenes jane perdorur edhe ne shkollen e Morostarit, ku 10-11 mesues jane duke monitoruar me shume se 15-20 nxenes, midis te cileve edhe Edison Xhelali, Eduard Hoxha, Xhevit Zyberi, Erxhem Shima, Artur Mece, Adelina Avduli, Silvana Xhelali etj.

Praktika te mira pune dhe rezultate pozitive u permenden gjate kesaj seance edhe nga pjesemarresit e shkolles se Zhupanit, te cilet, pavaresisht nga veshtiresite, po punojne individualisht me disa nga nxenesit qe kane probleme ne vijimin rregullisht dhe pervetesimin e programeve mesimore.

Ishin vertete mbreselenese te gjitha ato qe pjesemarresit treguan ne kete seance, ne prezence edhe te Drejtorit te Drejtorise Arsimore Rajonale te Fierit, z. Tahir Kastrati, i cili shprehu kenaqesine qe mori pjese ne kete seance dhe njohu nga afer keto pervoja, duke premtuar, ne te njejten kohe, bashkepunim te metejshem efektiv me sindikatat, si dhe mbeshtetjen personale dhe te DAR per nje angazhim akoma me te madh te te gjitha strukturave ne rreth e ne shkolla per vazhdimin e kesaj pune edhe ne te ardhmen.




Arritja e objektivave te caktuara ne kuadrin e ketij Projekti per shmangien e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve edhe ne kete seminar u pa e lidhur ngushte me forcimin e dy sindikatave tona te arsimit. Me kete synim u organizua edhe nje seance e vecante, ku pjesemarresit bene pyetje dhe ngriten probleme qe kane te bejne me shtimin e sherbimeve ndaj anetareve, reagimin ndaj rritjes se cmimeve dhe uljes se nivelit te jeteses se mesuesve e familjeve te tyre, zbatimin e disa neneve te Kontrates Kolektive te Punes, vecanerisht ato qe kane te bejne me Statusin e Mesuesit, sistemin e kualifikimeve, etj.

Drejtuesit e sindikatave qendrore bene shpjegimet dhe informuan mbi objektivat e vitit 2008, duke kerkuar, ne te njejten kohe, me shume mbeshtetje edhe nga seksionet sindikale ne rreth dhe keshillat sindikale ne shkolla.

# Takime te rendesishme me perfaqesues te DAR e ZA ne qarqet e Korces dhe Fierit

Takime te rendesishme jane organizuar kohet e fundit, ne kuadrin e zbatimit te Projektit me FNV/AOb, me perfaqesues te Drejtorive Arsimore Rajonale dhe te Zyrave Arsimore te qarqeve te Korces dhe Fierit

Ne takimin qe u organizua ne qarkun e Korces, moren pjese edhe perfaqesues te Zyrave Arsimore te Devollit, Pogradecit e Kolonjes, ndersa ne takimin qe u zhvillua ne qarkun e Fierit moren pjese edhe perfaqesues nga Zyrat Arsimore te Mallakastres e Lushnjes.

Ne te dy takimet drejtuesit e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, paraqiten, ne emer te te dy sindikatave, mendimet e propozimet ne lidhje me zgjerimin e partneritetit midis te dy institucioneve, DAR e ZA, nga njera and the sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, nga ana tjeter. Ata vleresuan institucionalizimin e ketyre mardhenieve, nepermjet Kontrates Kolektive te Punes dhe vune ne dukje perpjekjet qe po bejne te dyja sindikatat, jo vetem per mbrojtjen e interesave social - ekonomike te anetareve, por edhe per te kontribuar drejtperdrejt ne zhvillimin cilesor te arsimit, kualifikimin e mesuesve, uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.

Perfaqesuesit e sindikatave vleresuan, gjithashtu, angazhimin e Drejtorive Arsimore dhe drejtorive te shkollave per aktivitetet qe kane ndermarre sindikatat e arsimit, sidomos ne drejtim te mbrojtjes se femijeve dhe realizimin e objektivave te mijevjecarit per nje arsim cilesor per te gjithe, por nderkohe kerkuan forcimin e metejshem te ketij bashkepunimi, sidomos duke perdorur me mire mesuesit e trajnuar nga sindikatat, materialet qe ato kane botuar me ndihmen e partnereve nderkombetare, si edhe motivimin me te mire te mesuesve qe jane te angazhuar mbi kohen normale te punes dhe kane rezultate te mira ne punen individuale me nxenesit qe kane braktisur ose jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, duke perdorur me mire dhe me me efikasitet edhe buxhetin e Fondit te Vecante.

Vemendje te vecante terhoqen ne keto takime ceshtjet qe lidhen me zbatimin e detyrimeve ligjore qe kane Dretorite dhe Zyrat Arsimore per kryerjen e veprimeve financiare, ne lidhje me zbritjen e kuotes se anetaresise se mesuesve anetare te FSASH e SPASH, nga liste pagesat. Drejtuesit e sindikatave sqaruan kuadrin ligjor te ketij veprimi financiar, bazuar ne Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive te Punes, si edhe ne listat e rregullta te anetaresise te firmosura nga secili prej anetareve, ku theksohet se pranohet mbajtja e kuotes se anetaresise, duke e zbritur ate nga borderoja perkatese.

Me te gjitha keto materiale, si edhe me botimet me te fundit per Modulet SCREAM, Manualin mbi Arsimin Joformal, numrat e fundit te Revistes «Tribuna Sindikale» ishte pergatitur nje dosje e vecante per secilen nga Drejtorite Rajonale dhe Zyrat Arsimore, gje qe u vleresua nga pjesemarresit ne keto takime.

Diskutimet ne te dy takimet ishin konstruktive dhe secila prej paleve mori pergjegjesit e veta per forcimin e meteshem te partneritetit real midis tyre, ne funksion te mbrojtjes se interesave te mesuesve dhe zhvillimit cilesor te arsimit ne vendin tone.

# Me shume angazhim e pergjegjesi nga ana e drejtuesve te seksioneve ne rrethe

## Nga mbledhja e KD te FSASH

Keshilli Drejtues i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, i mbledhur keto dite ne Tirane, beri analizen e punes per vitin 2007 dhe percaktoi drejtimet kryesore te punes per vitin 2008.

Ne prani te drejtuesve te seksioneve sindikale nga 30 rrethe te vendit, Kryetari i kesaj Federate, z. Xhafer Dobrushi, ne fjalen hyrese te paraqitur ne emer te Kryesise, beri vleresimin per punen e bere gjate vitit 2007, duke u ndalur sidomos tek disa nga arritjet e problemet me te cilat u ndesh levizja sindikale gjate ketij viti, dhe parashtroi drejtimet kryesore te punes dhe sfidat me te cilat do te perballet kjo levizje gjate vitit 2008.

Ai theksoi se mbas nenshkrimit te Kontrates Kolektive te Punes qe u be me 4 korrik 2006, sfida me e madhe me te cilen u perball FSASH dhe seksionet sindikale ne rrethe ishte realizimi nga punedhenesi, sidomos ne nivelin e dyte, te dispozitave te kesaj kontrate.

Interpretimi subjektiv dhe i gabuar i dispozitave te KK te Punes te nivelit te pare per statusin e mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike ose shkolla te tjera profesionale te profilit te mesuesise, ngjalli shqetesime serioze ne nje mase te madhe mesuesish, sidomos

ne rrethet e Pogradecit, Devollit, Pukes, etj. Ishte vendosmeria dhe kembengulja e Kryesise se FSASH

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

dhe Seksioneve Sindikale perkatese qe beri te mundur kthimin ne pune te dhjetra e dhjetra mesuesve te larguar nga puna padrejtesisht. Per disa nga keta mesues seksionet sindikale vazhdojne edhe sot proceset gjyqesore.

Sfide tjeter me te cilen jane perballuar dhe do te vazhdojne te perballen sindikatat e arsimit eshte levizja e madhe, pa kriter , pa shkaqe objektive e qindra mesuesve dhe drejtuesve nga shume DAR e ZA. Megjithese ne KK te Punes jane sanksionuar rastet kur mesuesi mund te levizet nga vendi i punes, megjithese ka kritere per levizjen e drejtuesve, drejtoret e shume Drejtorive dhe Zyrave Arsimore vazhdojne praktiken e transferimeve panderprerje gjate gjithe vitit. Kjo praktike antiligjore ngjall pasiguri dhe frike te mesuesit, pse jo dhe tek drejtuesit e shkollave, sepse si te paret ashtu dhe te dytet behen pre e qendrimeve subjektiviste, partiake, hakmarrese, duke fshehur pas tyre edhe interesa

Korruptive.

Te gjithe diskutantet qe folen ne mbledhje shprehen vendosmerine per t'u perballur e per t'u prere rrugen ketyre veprimeve, sepse ato shkelin te drejtat e punesimit te ndershem te mesuesve sindikaliste, te drejtuesve ne nivel shkolle dhe mbi te gjitha i sjellin nje dem te pallogaritshem stabilitetit dhe progresit te zhvillimit te reformave ne arsim dhe modernizimit te ketij sektori jetik te shoqerise.

Mbledhja u ndal vecanerisht ne punen qe duhet bere per zbatimin e shume dispozitave te KK te Punes, sic jane ato per Statusin e Mesuesit, per vjetersine ne pune, per motivimin me te mire te mesuesve.

Por ajo qe terhoqi me shume vemendjen e Keshillit Drejtues te FSASH ishte puna qe duhet bere gjate ketij viti per rritjen e kapaciteteve te seksioneve sindikale, me synimin qe keto seksione te drejtojne e veprojne jo si individe por si organe kolegjiale, qe te rritet kapaciteti i tyre per te dialoguar , per t'u bere partnere serioze e te pergjegjshem perballe punedhenesit, perballe Drejtorive dhe Zyrave Arsimore per shtrimin, diskutimin dhe zgjidhjen e kerkesave te sindikalisteve qe ata perfaqesojne, per zbatimin me korrektesi te dispozitave te Kontratave Kolektive si te nivelit te pare ashtu edhe te nivelit te dyte.

Ne Keshill u vu theksi tek kuptimi real e bashkekohor i partneritetit social ne arsim, ku te dy palet, si punedhenesi ashtu edhe sindikatat ne rolin e punemarresit, megjithese ndodhen balle per balle, ne thelb kane dhe duhet te kete nje interes te vetem, te perbashket, qe eshte zhvillimi e modernizimi i sistemit te arsimit, permiresimi cilesor i sherbimeve qe ofron shkolla, objektiva qe nuk mund te arrihen pa demokratizimin e sistemit, pa mbrojtjen sociale ekonomike te sindikalisteve dhe mesuesve, pa motivimin, respektimin dhe lartesimin e figures se mesuesit.

Keshilli Drejtues i FSASH miratoi programin e punes dhe objektivat per vitin 2008, midis te cilave me kryesoret jane forcimi i partneritetit social ne nivelin e dyte, riorganizimi dhe forcimi i punes ne disa seksione sindikale si ai i Elbasanit, Beratit, Lushnjes, Kukesit, Krujes, Mirdites, etj, zgjidhjen e problemit te shperblimit per mesuesit qe dalin ne pension dhe ne pergjithesi motivimin me efektiv te mesuesve sindikaliste qe bejne pune cilesore, miratimin e Statusit te Mesuesit dhe Kodit te Etikes, vazhdimin e programit per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, punen me grate dhe mesuesit e rinj, etj. Ne objektivat e ketij viti nje vend te vecante do te kete perpunimi dhe zgjerimi i listes se sherbimeve qe sindikatat u ofrojne jo te gjithe mesuesve, por vetem anetareve te tyre.

Ne vazhdim, Keshilli degjoi nje raport nga Sekretari i Pergjithshem i Federates, Stavri Liko, mbi veprimtarine ekonomiko-financiare te Federates per vitin 2007 dhe projekt buxhetin per vitin 2008.

Ne raport theksohet se bilanci financiar i FSASH per vitin 2007 ka tregues te afert dhe pothuajse te njejtat karakteristika si ai i ketyre tre-kater viteve te fundit, megjithe veshtiresite ne rritje, sidomos per shkak te disa qendrimeve politike dhe veshtiresive sociale dhe ekonomike me te cilat perballen shumica e mesuesve dhe familjeve te tyre.

Pasi paraqiti shifrat konkrete per te ardhurat e shpenzimet, raporti thekson se ka akoma shume rezerva per rritjen e te ardhurave nga kuotizacioni, nderkohe qe shpenzimet konsiderohen normale per nje aktivitete kaq te gjere sic eshte ai i FSASH-it.

Duke u ndalur tek te ardhurat nga kuotizacioni, ne raport theksohet se peshen kryesore vazhdojne ta mbajne rrethet qe kane krijuar nje tradite te mire tashme ne grumbullimin e te ardhurave nga kuotat si: Tirana Qytet, Vlora, Mallakastra, Skrapari, Kuçova, Tirana rreth, Fieri, Kavaja, Kurbini, Permeti, Librazhdi, Pogradeci, Tepelena, nderkohe qe u terhoq vemendja per rrethe si Durresi, Devolli, Kuksi, Korca, Gjirokastra, Dibra, Gramshi, Puka, Shkodra, Mati, Bulqiza, Lezha, Saranda, Tropoja, te cilet kane mundesi shume me te medha se realizimet e vitit 2007.

Ne menyre te vecante u terhoq vemendja per disa rrethe si Delvina, Hasi, Kruja, Lushnja, Malesia e Madhe, Mirdita, Peqini ku vazhdojme te kemi probleme te medha edhe organizimi e funksionimi, per te cilat iu ngarkua detyre Kryesise qe gjate vitit 2008 te organizoje nje pune konkrete per te permiresuar gjendjen.

Fatbardha Keco
Zv/Kryetare e FSASH

# Te zbatojme Kontraten Kolektive te Punes dhe te sigurojme me shume sherbime per anetaret

## Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH

Keto dite u mblodh Keshilli Kombetar i SPASH, ku moren pjese perfaqesues pothuajse nga te gjitha rrethet e vendit.

Ne raportin qe mbajti kryetari i SPASH-it Bajram Kruja u ndale kryesisht tek tre probleme kryesore qe preokupojne aktualisht strukturat e SPASH-it nga qindra ne rrethe, te cilat jane: Zbatimi i Kontrates Kolektive te Punes dhe sigurimi i sa me shume sherbimeve per anetaret, aprovimi i veprimtarise sindikale per vitin 2008 dhe riorganizimi i mbeshtetur ne ndryshimet e DAR dhe ZA.

Ne kete raport u theksua se pas ndryshimeve ne fund vitit 1990, edhe roli i organizatave te punemarreseve do te ndryshonte dhe per kete arsye me 11\03\1991 u krijua me vendim gjykate: Bashkimi i Sindikatave te Pavarura te Shqiperise, ku nje nder themeluesit do te ishte ARSIMI.

Me 28 mars 1991 behet aktivi i pare ne Tirane ku hidhen idete e para per qellimin, rolin, organizimin e veprimtarise se organizates te lidhura me profesionin tone. Arrihen dy marreveshje me 23 shtator 1991 dhe 17 shtator 1993 ndersa kontrata e pare kolektive, pas shume veshtiresive, u firmos me 8 shtator 1994 ndermjet SPASH dhe MASH. Realizimi i saj ishte si rezultat i vendimeve te Kongresit te Pare te SPASH te mbajtur me 12/14 mars 1994. Ne pervjetorin qe u organizua vitin qe kaloi, perveç te tjerave, ne nje flete palosje shkurtimisht jane paraqitur te 6 kontratat kolektive, qe ne te vertete shume prej jush kane kontribut te madhe jo vetem ne pergatitjen por dhe ne zbatimin e saj. Me keqardhje, por duhet te pranojme se jo vetem antaret por dhe disa drejtues ne shkolla e rrethe shtrojne pyetjen: "Çfarë na ka dhënë sindikata" ?, "Pse duhet te jemi antare"? etj...

Është e vertetë që kjo lloj krize është shqetesuese dhe ne disa sindikata moderne ne shtete te zhvilluara ekonomikisht, prandaj tema per sot, si edhe nje takim tjeter ne te ardhmen do te kete si ceshtje kryesore: Si dhe çfare sherbimesh te tjera brenda dhe jashte profesionit tone mund te ofroje sindikata. Kjo është tema e takimit te sotem, por perpara se te flasim per temen do te doja te permend disa avantazhe te kontrates kolektive te nivelit te pare. Neni 13/4 nder te tjera thekson: «Per t'u mundesuar marrjen ne veprimtari sindikale mbeshtetur ne nenin 181 pika 7 e Kodit te Punes, (drejtuesve sindikale ne rrethe), u reduktohet ngarkesa mesimore nga 5 deri 10 ore ne jave, sipas numrit te antarsise. Ndersa per seksionet sindikale ne qarqe qe kane me shume se 600 antare i reduktohet norma mesimore javore edhe nje personi te dyte ne 6/8 ore ne jave.

Neni 13/10 : Kryetarve te keshillave sindikale ne shkolla qe perfaqesojne me shume se 15 antare, nuk duhet te ju jepet klase ne kujdestari.

Neni 13/12, nder te tjera thushet: Per te lehtesuar pjesmarrjen e kryetareve te seksioneve sindikale te rretheve ne mbledhjet e keshillave drejtues qendror te tyre, per 4 ( kater ) mbledhjeve ne vit, drejtorite arsimore rajonale dhe zyrat arsimore te rretheve, mbulojne shpenzimet e udhetimit dhe dietat, mbi bazen e vertetimeve me shkrim te leshuara nga kryesite e sindikatave qendrore.

Neni 7/7 thushet: Me kerkesen e SPASH dhe te FSASH, te zgjedhurve ne kryesite e sindikatave, ne shkalle rrethi dhe keshilli sindikal u sigurohet leje e pagueshme per te marre pjese ne veprimtarite sindikale lokale, kombetare, e nderkombetare. Kerkesa i paraqitet DAR ose ZAR nga kryesite e seksioneve sindikale vendore, te pakten 5 dite perpara aktivitetit. Shume te rendesishme jane edhe: Neni 4/4 Punesimi, Neni 5, Ndryshimi i vendit te punes, Neni 7, Koha e pushimit, Neni 8, Sistemi i pagave dhe i shperblimeve 8/7; 8/11; 8/12; 8/13, Neni 11, Kushtet e punes 11/1

Ne nivel qendror jemi partner ne kodin e etikes, si dhe kemi dhene mendime per ristukturimin e kualifikimit.

Pas diskutimeve te shumta, ne mbledhje u aprovua strategjia dhe kalendari i veprimtarise te SPASH per vitin ne vazhdim.

Ne mbledhje u diskutua, gjithashtu, ne lidhje me rivendosjen e pagave ne DAR dhe ZA duke i hequr ato nga pushteti lokal, gje qe duhet ta konsiderojme si nje mundesi positive ne administrimin e kuotizacioneve. Per kete arsye jane zhvilluar seminare se bashku me Z. Dobrushi ne DAR Korçe e Fier, ndersa si SPASH ne Kuçove, Berat, Vlore, Shkoder, Tirane qytet dhe fshat, ku jemi ne mirekuptim te plote me to, ne qofte se, te mbeshtetur ne nenin 2/5 te kontrates kolektive, paraqesin lista te rregullta.

Ne mbledhje u bene diskutime edhe per disa ceshtje te ndryshme, te ngritura nga drejtuesit e seksioneve dhe anetaret e Keshillit Kombetar.

Bajram KRUJA

# MBI REFORMËN E SISTEMIT TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE

Pjese e rendesishme e Strategjise se Arsimit Parauniversitar eshte edhe reformimi i sistemit te zhvillimit profesional te mesuesve. Eshte e kuptueshme se modernizimi i gjithe sistemit te arsimit ne vendin tone, arritja e objektivave madhore per nje arsim cilesor publik dhe shanse te barabarta kerkon edhe mesues cilesore, te perkushtuar, kerkues ndaj vetvetes, te afte per t'u perballur me sfidat e shkences dhe teknologjise se sotme te perparuar.

Ketyre kerkesave nuk mund t'u pergjigjet sistemi i sotem i vjeteruar i kualifikimit profesional te mesuesve. Qendra Kombetare e Kurrikulave dhe Trajnimit ka hartuar nje draft projekt per Reformen e Sistemit te Zhvillimit Profesional te Mesuesve. Per t'u ardhur ne ndihme sindikalisteve dhe mesuesve qe te njihen me kete draft dhe per t'u dhene mundesi qe te shprehin mendimet e tyre, po botojme ne kete numer te "Tribunes Sindikale" pjeset mbi shkallet e karrieres se mesuesit, aplikimin per shkallet e karrieres, rolet profesionale dhe periudhen e licensimit.



SHKALLËT E KARRIERËS SË MËSUESIT

1. Karriera e mësuesit ka disa shkallë, me emërtime të posaçme, si tituj.

2. Secila shkallë përshkruhet nga lista përkatëse e standardeve.

3. Titulli i karrierës është për një lëndë ose fushë lëndore dhe për një grup-moshe të nxënësve.

4. Një mësues mund të aplikojë për titull karriere për më shumë se një lëndë ose fushë lëndore (p.sh për histori e gjeografi), ose për më shumë se një grup-moshe te nxënësve (p.sh për grup-moshën e arsimit të mesëm të ulët dhe për atë të arsimit të mesëm të lartë), ose edhe për specializime të posaçme (p.sh për fëmijët që nuk shikojnë)

5. Shkallët e karrierës janë te hapura edhe për mësuesit e shkollave private.

6. Shkallët e njëpasnjëshme të karrierës së mësuesit janë:

a) "mësues-fillestar" (sapo ka marrë diplomën universitare të mësuesisë),

b) "mësues" ose "mësues i licencuar"

c) "mësues specialist"

d) "mësues mjeshtër".

7. Pas titullit "mësues mjeshtër", mësuesi ka detyrimin të ndjekë disa module që kanë të bëjnë me të rejat e domosdoshme shkencore dhe metoda të reja të domosdoshme të mësimdhënie-mëimnxënies, të cilat diktohen nga politikat kombëtare arsimore. Nëse ai nuk fiton shumën minimale të pikëve për këto module, i pezullohen rolet profesionale.

8. Meqenëse tani pas fitimit të shkallës së fundit, mësuesi nuk ka mundësi për një shkallë të mëtejshme dhe meqë kjo periudhë "bosh" zgjat shumë vite, mund të futet një shkallë e fundit, sipas meritave të karrierës, të cilin e fiton një përqindje e caktuar e mësuesve me përvojë. Ky është një titull onorifik, që shoqërohet me pagë te posaçme ose ulje të posaçme të ngarkesës mësimore, por nuk mbrohet me provime.

APLIKIMI PËR SHKALLËT E KARRIERËS

1. Mësuesi vendos vetë nëse do të aplikojë për një titull të karrierës dhe kur.

2. Nuk mund të kapërcehet një shkallë e karrierës.

3. Aplikimi për fitimin e titujve të karrierës, përveç atij "mësues fillestar", bëhet në DAR/ZA-në

përkatëse.

4. Dokumentacioni që shoqëron aplikimin e mësuesit për një titull, përmban:

-Paketën e mësuesit.

-Rekomandim nga drejtori i shkollës i shoqëruar nga raporti profesional i nëndrejtorit pedagogjik..

5. Mësuesi fillestar ka të drejtë të aplikojë për titullin "mësues" të paktën pas një viti të ushtrimit të profesionit të mësuesit dhe të shumtën pas katër vjetësh.

6. Intervali kohor në mes titujve "mësues" dhe "mësues specialist" është 5 vjet.

Intervali kohor në mes titujve "mësues specialist" dhe "mësues mjeshtër" është 10 vjet.

ROLET PROFESIONALE

7. Secilës shkallë i korrespondojnë mundësi të caktuara të roleve profesionale.

8. Secili rol profesional shoqërohet me një pagesë shtesë ose me ulje të normës mësimore pa ndryshuar pagën.

9. Rolet profesionale janë:

-kryetar i ekipit lëndor,

-anëtar i komisionit kombëtar të vlerësimit të teksteve,

-vlerësues i testeve të provimeve kombëtare,

-vlerësues i teksteve në nivel kombëtar,

-mentor i studentëve,

-mentor i mësuesit fillestar,

-nëndrejtor pedagogjik i shkollës,

-trajner,

-mësuesit peripatetik(1)

-këshilltar në qendrat këshillimore[1] (këshilltar pedagogjik),

-anëtar jurish;

-kryetar jurish;

-anëtar këshillash kombëtare;

-etj

10. Një titull karriere është kusht i nevojshëm për një rol të caktuar profesional, por nuk është i mjaftueshëm. Një rol profesional ka standardet e veta dhe pretendluesi për një rol profesional duhet të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

11. Ushtrimi i një roli profesional është me afat të caktuar.

12. Mësuesi mund ta humbasë një rol profesional nëse pushon së përmbushuri standardet e atij roli. P.sh. ai mund të shkarkohet nga detyra e kryetarit të ekipit lëndor ose t'i hiqet e drejta për të qenë kryetar për një afat të caktuar.

13. Një rol profesional në një shkollë fitohet përmes aplikimit në atë shkollë.

PERIUDHA E LICENCIMIT

14. Shkalla e parë e karrierës është ajo e licencimit të mësuesit. Diploma e mësuesisë është e nevojshme, por jo e mjaftueshme për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Pasuniversitari- kandidat për mësues do të japë mësim për një periudhë dhe pasi të plotësojë standardin e mësuesit, merr licencën e mësuesit

15. Periudha e licencimit ka një numër minimum vitesh shkollore (një vit) dhe një numër maksimum vitesh shkollore (katër vjet).

Nëse mësuesi fillestar nuk aplikon për katër vjet rresht për titullin "mësues", e humbet të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit.

16. Mësuesi fillestar është me kontratë të përkohshme pune.

17. Mësuesi fillestar mund të jetë me normë të pjesshme ose të plotë mësimore.



18. Shteti nuk ka detyrimin që t'i sigurojë kandidatit periudhën e licencimit në zonën e vendbanimit të tij.

19. Për çdo vit të pritshëm shkollor, MASH shpall vendet e lira pë mësues dhe mësues fillestar në të gjithë vendin.

20. Që një mësues fillestar të kryejë licencimin, duhet të kërkojë në zona ku ka mësues pa arsimin përkatës ose mungesë mësuesish. Në këto raste ai të favorizohet me shtesë mbi pagën e tij fillestare.

21. Pas licencimit, mësuesi mund të qëndrojë në po atë shkollë ose mund t'i kalojë në listën e pritjes.

22. Paga e mësuesit-fillestar duhet të jetë shumë afër atij të mësuesit të shkallës pasuese të karrierës, në mënyrë që të mos defavorizohet mësuesi-fillestar. (diferenca e pagës 5%).

# T'i mësojmë nxënësit si të punojnë me librin

Nga Bashkim SALIASI

Koncepti "të mësuarit" ka dy ose më shumë kuptime që jepen nga autorë të ndryshëm. J. J. Roussean e përkufizon si "maninë tonë mësimdhënëse e pedanteske për t`u mësuar fëmijëve vazhdimisht atë që ata, shumë mirë, mund ta mësojnë edhe vetë". Për një biolog, të mësuarit është procesi nëpërmjet të cilit zhvillohet rrjeti neurotik i trurit. Për një specialist të reflekseve të kushtëzuara "teoria e të mësuarit lidh një ngacmim , me një reagim specifik". Sollëm këto tre argumente për të krijuar imazhin se si duhet ta kuptojmë nocionin "Mësim" i dhënë nga studiues të ndryshëm në periudha të ndryshme, dhe për të ardhur në ditët kur ne po jetojmë zhvillime të vrullshme të informatikës dhe marrjes së informacioneve nga burime të ndryshme. Kur njeriu i sotëm po fluturon drejt planetëve në kozmos dhe po zhytet drejt thellësive me badiskaf duke eksploruar fakte dhe argumente që flasin për një zhvillim të shpejtë në përpunimin e informacioneve, gjithashtu njerëzimi po përpunon informacione nga më të sofistikuarit, mbetet detyrë parësore që t`i transmetohet brezit të fëmijëve që të përgatiten në kohë dhe në hapësirë për t`u përballur me situatat që u krijohen në evolucionin e jetës së tyre. Të mësuarit është një proces njohës që i lejon nxënësit , në saj të bashkëveprimit ndërmjet organizmit dhe, mjedisit, të riparojë sjelljen e tij në mënyrë të shpejtë dhe të qëndrushme. Mendimet e dhëna nga psikolog të ndryshëm, "Të mësojë si duhet mësuar", ka qenë dhe mbetet aktual dhe sot në ditët tona. Po jap disa mendime të cilat janë pervojë e punës sime në bazën e disa studimeve të kryera në tre vitet e fundit duke u bazuar dhe në trajnimet e kryera për sa i përket mënyrës së të mësuarit nëpërmjet përsosjes së mësimëdhënies.

-Së pari, bëj kujdes që materialin e servirur ta jap sa më të plotë dhe shfrytëzojë në maksimum njohjet e nxënësve .

-Së dyti, më ka dhënë rezultat gërshetimi i njohurive të kapitujve dhe lidhja që ekziston ndërmjet lëndëve që e realizojë, nëpërmjet përsëritjes së vazhdueshme në evokim, por dhe në reflektim duke kaluar në situata problemore dhe praktikoj aktivizimin e nxënësve të pa vëmendshëm nëpërmjet një përsëritje të thelluar.

-Në radhë të tretë, gjatë dhënies së njohurive të reja, nxënësit vullnetarisht mbajnë shënim çështjet kryesore, dhe këto më kanë shërbyer në reflektim dhe në përsëritjen e lëndës .

-Së katërti, në thellimin e njohurive një rezultat të mirë më ka dhënë dhe motivimi i papritur dhe i befasishëm për ta mbajtur gjithnjë nxënësin në koherencë të çështjeve të reja që mos t'i krijohet mundësia, "që të bjerë në gjumë".

Lënda e Biologjisë dhe edukimi shëndetësor që ka më se tre vjet që mësohet nëpër shkollat publike e jo publike është cilësuar si një nga tekstet më të mira për sa i përket dhënies së njohurive bashkëkohore. E sjellim këtë argument, jo për të gjykuar tekstin, por për të parë ndërtimin e tij që njohuritë e trajtuara në të, të jenë të kuptueshme dhe përthithen shpejtë nga nxënësit. Njohuritë që përbëjnë objektin e të mësuarit, i cili realizohet në shkollë, gërshetohen dhe me të mësuarit spontan të realizuar nga nxënësit nëpërmjet formave të ndryshme të përvetësimit të dijeve, gjë e cila shoqërohet me reflektime në rritjen e rezultateve në mësime. Ndër strategjitë e të mësuarit në rritjen e rezultateve ndihmojnë dhe mbajtja e shënimeve për çështjet kryesore që trajtohen gjatë orës së mësimit, për të kaluar në vetëkontroll që nxënësit të mësohen si të kontrollojnë vetveten dhe të punojnë me tekstin. Detyrat që u jap nxënësve për në shtëpi i shoqëroj me sqarime se ku do mbështeten për t'i kryer që të ngulitin konceptet në funksion të temës dhe, në reflektimin kur kontrolloj detyrën dy-tre nxënësve i motivoj duke i pyetur se ku janë mbështetur për zgjidhjen e saj.

Mundohem që nxënësit të mos i ngarkoj me shumë detyra, por synoj që informacionin e ri që marrin në klasë, ta zbatojnë në praktikë, dhe kjo më ka dhënë rezultatet e duhura, që ka ndikuar si në cilësi dhe në sasi dhe shërben si nxitës që nxënësi të punojë me tekstin, të mbajnë shënime, të veçojnë kryesoret dhe të kalojnë në përgjithësime, këto reflektohen sidomos në zhvillimin e orëve të ekskursioneve.

Detyra për kujtesën në biologjinë

e klasës së VI i kam dhënë që të riprodhojnë informacionin që kanë mësuar në klasën e V p.sh në kapitullin:Frymëmarrja te gjallesat. Nga masa e nxënësve që unë drejtoj mësimin më bie në sy se 70% e klasës ruajnë informacionin e dhënë një vit më parë dhe në momentet që u kërkohet ose u dalin probleme i shfletojnë ato dhe arrijnë të analizojnë dhe të argumentojnë problemat që na lindin gjatë marrjes së informacionit të ri. Shembull i qartë është: Cikli i oksigjenit.

Dyoksidkarboni + ujë (në prani të dritës)=lëndë organike+oksigjen. Këtu e gjejë me vend të theksoj se kur unë kam përdorur udhëzime të sakta detyra i ka ndihmuar nxënësit që të mësojne dhe të riprodhojnë argumente sa më bindëse për problemin që shtrohet për zgjidhje dhe 60% sqarojnë ciklin e oksigjenit në mënyrë perfekte dhe nxjerrin në pah rolin që luajnë bimët për pasurimin e atmosferës me ketë element. E njëjta rrugë u ndoq dhe për ciklin e karbonit për të cilin nxënësit zotërojnë njohuri nga kapitulli i parë të marra në temën e mësimit: Aleancat ndërmjet gjallesave bimore dhe shtazore, në klasën e gjashtë. Po t'i referohemi rekomandimeve që jepen në Psikologjinë e të mësuarit shumë autorë kanë dhënë formula dhe rekomandime për mësimdhënie të suksesshme: Rishiko dhe kontrollo punën e një dite më parë. Paraqit material të ri, zhvillo mësimdhënien në hapa të vegjël, siguro shembuj të shumtë dhe sigurohu se nxënësit të kuptojnë. Komento dhe korrigjo gabimet,bazuar në përgjigjet e nxënësve. Siguro praktikë të pavarur, pra ti lemë nxënësit të zbatojnë të nxënit vetë, në klasë apo në shtëpi. Organizo përsëritjen, për të konsoliduar të nxënit.

I solla këto rekomandime në këtë material për të treguar se mësuesi duhet të kualifikojë vetveten për të pasur rezultat në mësimdhënie dhe të njihet me literaturën e re. Duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit të mësimdhënies, është e domosdoshme që theksi të vihet në strukturën e mësimit, atmosferën e klasës, e cila bën që mjedisi të jetë shoqëror dhe nxitës për të nxënit, sidomos, për ata që kanë rezultate të ulëta në mësime. Të mësuarit vë në lëvizje të gjitha aspektet e personalitetit dhe nuk mund të kufizohet në një punë të thjeshtë mekanike, pra dalim në përfundim se, përsëritja ose motivimi janë të nevojshëm por jo të mjaftueshëm, prandaj është e nevojshme që me ndryshimet e kryera vitet e fundit dhe punimi me tekste alternative kërkon që të japim dhe informacione shtesë dhe të bëjmë përgjithësime, të aftësojmë nxënësit për vet kontroll. Për të organizuar punën në klasë, une mendoj se mësuesi duhet të shfrytëzojë bazën materiale që disponon në zonën ku punon, apo e siguron vetë në punën e përditshme duke e përshtatur këtë bazë materiale me tekstin mësimor.

# Kishim vepruar drejtë

"Ai që përkujdeset për shpëtimin e të rinjve bën punën e hyjnive".

Plutarku

Nga Viron Kona

Ndodhesha në aeroportin "Nënë Tereza" në orët e para të mëngjesit për të përcjellë në SHBA një mikun tim. Ndihesha i përgjumur, kur befas dëgjova një zë përshëndetës:

-Drejtor, mirëmëngjesi, si jeni?

Ishte Edmondi, një ish nxënësi im që po më afrohej buzagaz.

I shtrëngova dorën dhe duke e parë drejt e në sy e pyeta:

-Po ti këtu, për ku je nisur?

-Për në SHBA. Kam përfunduar studimet atje, për elektronikë, tani punoj në një institucion shkencor.

-Je i kënaqur, ndihesh mirë?

-Po, shumë. Elektronika ka qenë ëndrra ime dhe...

E teksa bisedoja me djaloshin sillja ndërmend vitet kur ai ishte maturant dhe kur ...Ishte ora e dytë apo e tretë e mësimit, kur mësuesja kujdestare u fut në klasë gjithë vrull së bashku me Edmondin dhe Endrin, dy djemtë më "problematik" të asaj klase. Të dy dukeshin të skuqur në fytyrë dhe menjëherë e kuptova se ata ishin goditur me njëri-tjetrin.

-Ose unë në shkollë, ose këta të dy! - po thoshte mësuesja, e cila ndihej shumë e acaruar. Dhe, kishte të drejtë. Ne ishim shkollë me disiplinë të fortë dhe raste të tilla, sidomos në orën e mësimit nuk na kishin ndodhur. Në fillim edhe unë u zemërova shumë dhe më hipën nervat. Isha gati ta thosha fjalën e fundit, por nuk e di pse në ato çaste m'u kujtuan fjalët e një miku tim, i cili më kishte thënë:"Kur dua të marr një vendim të rëndësishëm, unë e mbaj përbrenda zemërimin dhe zë e numëroj deri në dhjetë". Mbase ishte kjo këshillë e mikut tim, e cila më bëri që t'i them

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

mësueses:

-Mësuese, ju lutem vazhdoni mësimin, kurse këta të dy le të qëndrojnë pak këtu me mua. Më pas do të gjykojmë dhe do të vendosim se çdo të bëjmë.

-Drejtor, nuk falen këta, e kanë mbushur kupën...! -Ajo ishte ende shumë e zemëruar dhe e acaruar.

Të dy djemtë kishin ulur kokat dhe s'flisnin. Nëpër faqet dhe qafat e të dyve dukeshin shenjat e goditjeve. E ndjenin se e kishin tepruar shumë dhe ndiheshin fajtor.

Orën tjetër zhvillova një mbledhje urgjente të drejtorisë. Thirra dhe mësuesen kujdestare, disa mësues të tjerë që jepnin mësim në atë klasë si dhe të dy nxënësit fajtor. Duhej të merrnim një vendim, aq më tepër që Edmondi e kishte rast të përsëritur. Më parë i kishim dhënë një vërejtje, kishim vënë në dijeni edhe prindërit e tij, dy njerëz të urtë që rropateshin gjatë gjithë ditës për të mbijetuar dhe për t'i plotësuar kushtet e shkollimit birit të tyre.

Në drejtori diskutuam gjatë. Mbledhja u zhvillua e tensionuar dhe me nerv.

-O unë, o ata, - përsëriste pareshtur mësuesja kujdestare

Me ç'po shikoja, një pjesë e mirë e diskutuesve, pavarësisht nga toni dhe kritikat e ashpra, dukeshin të lëkundur.

-Sikur ta diskutojmë edhe një herë nesër? - propozova.

-Si sot, si nesër ata nuk kanë më vend në këtë shkollë. - foli përsëri kujdestarja, por këtë radhë zemërimin e kishte me mua.

-Drejtor, je shumë tolerant, po na prish disiplinën e shkollës, këta duhet t'i përjashtojmë, ka marrë fund kjo punë, këta s'duhet të qëndrojnë më asnjë minutë në këtë shkollë. - ngulmonte edhe një mësuese tjetër.

-Megjithatë le të mos nxitohemi, - thashë unë, - nesër thërresim edhe kryetarin e Bordit dhe të Këshillit të prindërve dhe e diskutojmë një herë edhe me ata.

-Drejtor, po i mbajte në shkollë ata të dy, unë do të ankohem. Në Ministri do të shkoj. Po të paralajmëroj! - më tha kujdestarja duke dalë. Sigurisht që po e tepronte, por duke njohur zemrën e saj të pastër, sinqeritetin dhe zotësinë profesionale, nuk i dhashë kaq shumë rëndësi fjalëve të saj kërcënuese.

Mbeta vetëm në zyrë. Më duhej të merrja një vendim të rëndësishëm. Ishte viti 1999 dhe në Shqipëri gjendja ishte ende kaotike dhe e pa stabilizuar si duhej.

Ditën tjetër, sapo filloi mbledhja vura re se zemërimi dhe toni i diskutuesve ishte disi më i zbutur. Bashkërisht vendosëm që t'u jepnim edhe nga një mundësi tjetër djelmoshave "problematik", duke u dhënë edhe nga një vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga shkolla. Ashtu e mbyllëm mbledhjen.

Sillja ndërmend këto dhe e shikoja Edmondin në sy.Telashe të mëdha na kishte krijuar ai djalë, edhe mua, edhe mësuesve.

-Po me Endrin, je takuar? - e pyeta.

-Po, këmbejmë herë pas here ndonjë e-mail, jemi bërë shokë të ngushtë. Ai studion në Itali për matematikë. Ju e dini drejtor, ai ishte më i miri. Edhe atëherë ai nuk kishte faj, unë e kisha fajin, isha gjaknxehtë dhe doja të bëja të fortin e klasës. Ju kërkoj falje drejtor, edhe juve, edhe mësueses kujdestare, ajo është e mrekullueshme.

-Po, - iu përgjigja, - e rreptë vërtetë, por me dashuri të madhe për nxënësit, ju donte të bëheshit të ditur dhe të mirë.

-Me mësuesen kujdestare kam komunikuar shpesh. - vijonte të fliste djaloshi, - I kam kërkuar falje edhe atëherë, edhe më pas. Ajo ndihet e gëzuar që kam mbaruar për elektronikë.

Disa çaste e pashë djaloshin në sy. Dukej i prekur dhe i emocionuar.

-Askush nga ne s'ka zbritur nga qielli, - thashë, duke folur më shumë me vete dhe duke i rënë me dashamirësi shpatullave të djaloshit. Pastaj befas e pyeta:

-Po sikur të të kishim përjashtuar, çfarë do të kishe bërë?

Ai heshti, pastaj duke më parë drejt e në sy më tha i menduar:

-Nuk e di drejtor, mbase.., mbase do të isha nisur për në Itali me...gomone.

Mondi! Mondi! - u dëgjua një zë vajze që po afrohej drejtë nesh.

-Ela, njihu me drejtorin tim, - i tha djaloshi vajzës. Ajo më dha dorën duke buzëqeshur dhe, duke më parë me kureshtje më tha: - Mondi më ka folur për ju.

-Ela është shoqja ime..., e ngushtë, - tha djaloshi. - Edhe kjo për elektronikë është, por do edhe dy vjet që të përfundojë studimet.

Ndërkohë po shkonte ora dhe u ndamë duke këmbyer numrat celularëve dhe adresat e e-malit.

Dhe, teksa Edmondi me Elën largoheshin krah per krah, mua me erdhen ndërmend fjalët e vjetra të Plutarkut:. "Ai që përkujdeset për shpëtimin e të rinjve, bën punën e hyjnive". Dhe, Plutarku i madh, me siguri kur kishte thënë ato fjalë, mbase më shumë se këdo tjetër, kishte pasur parasysh mësuesit.

# Të reja shkencore

### GOXHA E ËMBËL

Tani ka dalë në treg kjo bateri që punon me sheqer dhe është e padëmshme për ambientin. Bateria Bio e Sony-t përdor elementët e glukozës për të nxjerrë



elektronet në mënyrë që të gjenerojnë energji. Lidhni 4 nga bateritë 50 milivatëshe dhe keni energji të mjaftueshme për të vënë në punë MP3-shin tuaj.

### MIRËMËNGJES RREZE DRITE

Shumica e njerëzve i urrejnë alarmet e orave në mëngjes. Ja pse Eoin McNally ka krijuar jastëkun e ndriçuar. I pajisur me një elemente dritash LED, ai përdor vetëm dritë për të të zgjuar. Rreth 40 minuta para zgjimit jastëku i programueshëm fillon të ndriçojë, gradualisht, duke u zbardhur gjithnjë e



më shumë në mënyrë që të realizojnë dritën natyrale të lindjes së diellit. Kjo ju ndihmon që ta filloni ditën sa më thjeshtë.

### PA PENDIME

Tani që tatuazhet janë më popullore se



kurrë ndonjëherë, është momenti për të shpjeguar një mënyrë të besueshme për t'i hequr. Një në pesë persona pendohen për tatuazhin që kanë. "Freedom-2 ink" është e përbërë nga një bojë e veçantë në plastik në vend të metaleve që shumica e bojrave përdorin, kështu tatuazhet mund të hiqen vetëm me një trajtim.

### SYZET LEXUESE

Kërkuesit në universitetin Carlo III të Madridit, duke punar për t'u ardhur në ndihmë personave që nuk dëgjojnë, kanë arritur të realizojnë një mënyrë që edhe ata të ndjekin programet televizive pa vështirësi. Kjo realizohet nëpërmjet



ekranit të vogël që ndodhet pranë anës së djathtë të syzeve, i cili regjistron tekstin që kalon tek ai nga ajri, duke ndjekur rigorozisht filmin.

# Keshilla praktike

## DHJETE GABIME TË PERSONAVE QË KËRKOJNË PUNË

*Flisni shumë shpejt, evitoni kontaktin e syve, bëni shumë pyetje, perdorni shumë parfum, gënjeni për eksperiencat e punës, shkoni me vonesë në intervistë, nuk bëni kërkime në lidhje me firmën; bëni të gjitha këto dhe çuditeni pse nuk e fituat atë vend pune?!*

*Nuk ka asnjë intervistë perfekte, por shumica e gabimeve mund të evitohen duke patur pak kujdes.*

*Ja ku janë 10 gabime të zakonshme që personat që kërkojnë për punë duhet t'i evitojnë.*

### 1. Gati...Zjarr

Mos humbisni kohë duke dërguar CV gjithandej para se të keni vendosur cila është puna juaj ideale. Kur shkoni pas punëve për të cilat nuk jeni të kualifikuar, do t'ju ndodhë të refuzoheni më shpesh. Synoni pozicionin që përzgjidhni dhe ndiqni karrierën tuaj me vendosmëri.

### 2. Si të silleni

Mos e thërrisni asnjëherë intervistuesin tuaj në emër, duke përfshirë këtu edhe ata që janë më të rinj se ju në moshë. Adresojuni në mënyrë formale, përveç rasteve kur ju kërkon vetë që ta thërrisni në emër.

### 3. Jeta juaj është një libër i hapur

Jetën tuaj private mbajeni private.

### 4. Mosinteresimi

Një ndër gabimet që dallohen menjëherë gjatë një interviste pune është fakti që i interesuari nuk ka bërë kërkimet e nevojshme për të kuptuar pozicionin dhe kompaninë në të cilën po aplikon.

### 5. Të neglizhosh pamjen e jashtme.

E keni dëgjuar më parë, do ta dëgjoni përsëri. Mos u vishni në mënyrë shumë provokuese, as rastësore, mos vini shumë bizhuteri. Vishuni në përputhje me këerkesat e pozicionit për të cilin po aplikoni.

### 6. Të aplikosh thjeshtë për të aplikuar

Aplikoni vetëm për pozicionin dhe kompaninë që ju intereson. Shkoni pas asaj pune ashtu si atletët olimpikë shkojnë pas medaljes. Mos humbisni kohë duke aplikuar për pozicione të cilat nuk ju interesojnë vërtet.

### 7. Të mos flasësh

Intervistuesi nuk pëlqen përgjigje të thata, "po" ose "jo". Duhet të mbështesni përgjigjen tuaj me argumenta dhe shembuj që lidhen me eksperiencat tuaja të punës. Nga ana tjetër, mos flisni shumë. Kjo tregon nervozizëm ose paaftësi për të dhënë një përgjigje të drejtpërdrejtë.

### 8. Të dërgosh një CV prej 10 faqesh

Ky është gabim i madh, pasi këshillohet që t'i përmblidhni të gjitha aftësitë tuaja vetëm në një faqe. Mbani mend se personi që sheh CV-të tuaja ka 15 sekonda kohë në dispozicion për të vendosur për t'ju marrë në intervistë apo jo.

### 9. Të flasësh negativisht për ish punëdhënësit tuaj.

Nuk ka rëndësi se ku doni të dilni. Kritikat ndaj ish punëdhënësve tuaj nuk janë aspak të nevojshme. Nëse ju kërkohet të flisni për punët tuaja të mëparshme, përgatituni të përmendni diçka pozitive që ka qenë e vlefshme për karierën tuaj.

### 10. Të mos bësh pyetje të vlefshme

Bërja e pyetjeve pa asnjë rëndësi tregon se nuk ju intereson edhe aq kompania ose pozicioni për të cilin po aplikoni. Bëni pyetje të tilla si: çfarë të ardhme ka ky pozicion? Pse ky pozicion është vakant? Çfarë mund të bëj për të qenë i suksesshëm?

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE

